

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

30 Korrik, 2021

Te Dashur Prindër, Familje dhe Studentë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias

Departamenti i Shëndetit Publik të Filadelfias (PDPH) ka lëshuar udhëzimet e sapo rishikuara për rihapjen e shkollës, i cili - si *Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve* - i jep përparësi kthimit të sigurt të të gjithë studentëve për të mësuar në-person me shumë masa sigurie. Angazhimi ynë ndaj jush është që të përmbushim ose tejkalojmë këtë udhëzim për të ndihmuar në ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së të gjithëve pasi ne i mirëpresim të gjithë studentët të kthehen në shkollë për të mësuar në-person pesë ditë në javë të Martën 31 Gusht.

Ky [School Year At-Glance](#) tregon atë që mund të prisni kur të hapen përsëri shkollat. Këtu janë disa nga pikat kryesore:

- **Mbajtja e Maskës**-Të gjithë duhet të mbajnë një maskë ose një mbulesë tjetër të fytyrës të aprovuar kur janë brenda, pavarësisht nëse janë të vaksinuar ose të pavaksinuar.
- **Testimi COVID-19** - Ne do të vazhdojmë testimin tonë të detyrueshëm javor për të gjithë punonjësit dhe mund të përshtatet gjatë vitit. Testimi në vend do të jetë i disponueshëm për studentët që kanë simptoma të ngjashme me COVID gjatë ditës. Ne gjithashtu do të ndjekim një model “Test to Stay”: Kontaktet e ngushta të rasteve pozitive do të testohen të paktën 3 ditë jo rresht brenda 7 ditëve të para pas ekspozimit. Ata që mbeten negativ gjatë testimit mund të qëndrojnë në shkollë dhe nuk duhet të bëjnë karantinë. Rastet pozitive duhet të izolohen për të paktën 10 ditë.
- **Vazhdimësia e të mësuarit** - Studentët që janë në karantinë ose të izoluar do të marrin mbështetje mësimore ndërkohë që janë në shtëpi.
- **Atletët** - Ne do të ndjekim një model “Test to Play”: Atletët që luajnë sporte me rrezik të lartë dhe arte skenike (band dhe kor) do të testohen 1-2 herë në javë. Atletët dhe studentët e arteve skenike të vaksinuar mund të përjashtohen nga testimi javor me dëshmi të vaksinimit.
- **Distancimi fizik** - ndërsa distanca prej 3 feet rekomandohet dhe do të inkurajohet kur është e mundur, përparësia si nga CDC ashtu edhe nga PDPH është kthimi i plotë i studentëve në shkollë me shumë masa sigurie.

Siç kam thënë më parë, çdo shkollë do të ketë gjithashtu pastrues të ajrit dhe sipërfaqes, stacione pastruese të duarve pa prekje dhe stacione hidratimi pa prekje.

Ne jemi të gëzuar dhe të gatshëm për të mirëpritur të sigurtë të gjithë studentët në shkollë për të mësuar në-person, disa për herë të parë në më shumë se 18 muaj. Ardhja përsëri në-person dhe

rrethimi i tyre me edukatorë të kujdesshëm dhe mbështetje kritike është mënyra më e mirë për t'i ndihmuar ata të fillojnë të shërohen, rriten dhe të ri-angazhohen në mjediset shoqërore që janë kritike për zhvillimin e tyre.

Studentët dhe familjet me rrethana lehtësuese që duan të qëndrojnë virtualë mund të regjistrohen në Akademinë Virtuale të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias (PVA). Është e rëndësishme të kuptohet se PVA është shumë e ndryshme nga studentët e të mësuarit virtual që kanë përjetuar që nga Marsi i vitit 2020. Studentët PVA nuk do të qëndrojnë të regjistruar ose të marrin udhëzime nga mësuesit në shkollën e tyre aktuale. Ata do të përfshihen në mësim 100% të pavarur në orarin e tyre duke përdorur burimet e të mësuarit të siguruara nga një mësues i caktuar. Në vend që të marrin pjesë në aktivitete atletike ose jashtë-kurrikulare në-person në shkollën e tyre aktuale, studentët do të marrin pjesë në aktivitetet jashtëshkollore të ofruara nga PVA. Prindërit / familjet e interesuara në PVA mund të vizitojnë philasd.org/pva për të mësuar më shumë dhe për të plotësuar një PVA Intake Form. **Dritarja dy javore e regjistrimit në PVA për vitin shkollor 2021-2022 është e Hëna, 2 gusht deri të Premten, 13 gusht.** Unë inkurajoj çdo familje të interesuar në këtë opsion virtual që të konsiderojë me kujdes të gjithë informacionin pasi përcakton zgjedhjen më të mirë për fëmijën e tyre.



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias